



dukat<sup>®</sup>

# Raporti Vjetor Kompania Lufra dhe Dukat 2021

Data:  
23 Dhjetor 2021





# Një përmbledhje nga Drejtuesit e kompanisë

"Të dashur miq,

Dëshiroj të nis këtë përmbledhje të shkurtër të vitit 2021 me një falenderim të madh për të gjithë punonjësit e familjes së madhe "Lufra", bashkëpunëtorët e partnerët tanë për mbështetjen dhe fermerët e palodhur që na ofruan lëndën e parë të një cilësie maksimale.

Viti 2021 na përballi me sfida të reja por edhe shumë mundësi për t'u rritur, zgjeruar e fuqizuar në treg. Ky vit shënoi fillimin e eksporteve me Shtetet e Bashkuara të Amerikës, zgjerimin e kompanisë 'Lufra' në Kosovë dhe implementimin e investimeve në përmirësimin e cilësisë dhe standarteve tona të prodhimit. Nese do te kujtoni shume prej jush e mbajne mend fillimin e ketij viti me Startin e sistemit NAV. Tashmë mund të themi me krenari se pas një viti sfidues, me zhvillime për sistemin kemi arritur të implementojme thujse çdo gjë që kishim në plan dhe tashmë kemi mbi 90% të të dhenave të kompanise të dixhitalizuara.

E ndërsa vijojmë të punojmë me të njejtin intensitet dhe ambicie për të vazhduar përpara, gjithmonë ndihemi të motivuar nga besimi i konsumatorëve tanë të cilët zgjedhin Lufra prej 29 vitesh tashmë. Jam i sigurt që viti 2022 do sjellë më shumë mundësi dhe më shumë realizime të ëndrrave, prandaj do doja ta përmbyllja me deklaratën tonë të vizionit: Të bëjmë produktet 'Made in Albania' të dëshiruara dhe të besuara në të gjithë botën!"

Z. Luis Ndreka, CEO

## Zhvillimi i drejtpërdrejtë i fermave

Përveç formulës së llogaritjes së cmimit për fermerët kemi ndihmuar në zhvillimin e drejtpërdrejtë të më shumë se 10 fermave duke i financuar direkt për investime që kanë patur nevojë, për të rritur cilësinë dhe kapacitetet prodhuese.

## Rritje e kërkesës në treg

Pavaresisht ndihmës ndaj fermerëve dhe investimeve të përbashketa, sezoni i verës pati një kerkese më të lartë se parashikimet tona dhe për ta përballuar na u desh të plotesojmë kërkesën duke blerë lëndë të parë qumësht të freskët edhe nga kompani prestigjioze ndërkombëtare.

## Kushtet e punës

Përveçse tashmë kemi një strukturë organizative më të qartë sesa në fillim të ketij viti ku secili di punën dhe detyrat e tij, kemi arritur të ulim ndjeshëm qarkullimin e punonjësve në pothuajse çdo departament. Kjo është një indicie shumë e mirë e cila tregon për një ambient pune më të shëndetshëm.





## Sistemi Dixhital

Tashmë kemi një sistem dixhital të sigurt dhe akoma më transparent për kompensimin e fermerëve tanë i cili nxit përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë dhe sasisë së qumeshtit që ata prodhojnë dhe shesin tek Lufra.

## Investime strategjike



## Eksportet në SHBA

Nje zhvillim tjetër strategjik gjatë ketij viti i cili bën një hap të madh drejt realizimit te misionit tonë ishte edhe fillimi i ekporteve drejt SHBA duke u pasuar me hapjen e filialit tone në Prishtinë, Kosovë ku presim të fillojme shitjen në ditet e para të muajit Janar 2022.

Gjatë këtij viti siç edhe ishte premtuar në 2019, pothuajse ka përfunduar parku i ri logjistik në Lushnje me hapsira të reja parkimi dhe shërbimi. Disa investime të reja në teknologji prodhimi dhe paketimi shumë të rëndësishme për sigurinë e produkteve siç janë: makineria Krones për prodhimin e shisheve plastike, makineria e re e mbushjes së kosit me gota dhe makineria e re e paketimit të gjalpit. Këto investime teknologjike rrisin sigurinë e produktit për konsumatorin duke na sjelle një hap më pranë misionit tonë: “Ti bëjmë produktet ‘made in Albania’ të dëshiruara dhe të besuara në të gjithë botën”.

Mendojnë për  
Brandin tonë  
**91%**

Për herë të parë kemi matur preferencat e konsumatorëve për produktet Lufra dhe jemi krenare tju tregojmë që për shkak të punes së të gjitha skuadrave në departamente të ndryshme, 91% e konsumatoreve përmendin markën Lufra të parën kur flasin për produkte bulmeti.

# Zhvillimet në Departamentin HR



Punonjës  
**+265**

Femra në rolet  
administrative dhe laborator  
**+55%**

Punonjësit tanë janë një ndër shtyllat kryesore ku mbështetemi për mbarëvajtjen e punës. Trajnimi, motivimi, zhvillimi i tyre në karrierë tregon shumë për kompaninë tonë. Përgjatë këtij viti u zvogëluar ndjeshëm norma e qarkullimit të punonjësve dhe mund të përmendim shumë raste sukseesi të punonjësve që janë pjesë e familjes Lufra pothuajse që në gjenezat e saj duke u rritur shkallë-shkallë profesionalisht.

## Programe Trajnuese



Përgjatë vitit 2021

3120  
Orë Trajnimi



26 programe trajnuese

Përgjatë këtij viti zhvilluam politika për rritjen e produktivitetit të punonjësve dhe motivimin në punë. Po ashtu nënshkruam një marrëveshje me United Nations Population Fund of Albania (UNFPA) për mjedise miqësore me familjen. Mbeten për tu theksuar edhe marrëveshjet me Universitetet Private dhe Shtetërore, Shkollat Profesionale në Shqipëri për të ndihmuar zhvillimin dhe punësimin e studentëve nëpërmjet programeve tona të intershipit dhe praktikave në punë.

Barazia gjinore, meritokracia dhe puna e pastër janë ato që ne vlerësojmë, dhe nuk bëjmë asnjë dallim gjinor, racor, fetar apo të aftësive fizike në punësim.

Në kompaninë Lufra, vlerësimi i punonjësve dhe motivimi e zhvillimi i talentëve janë ndër faktorët kyç që na diferencojnë.

Për këtë arsye ne kemi krijuar një platformë e cila përmban programe trajnuese për punonjësit e çdo departamenti, me qëllimin e zhvillimit të aftësive profesionale dhe ndërpersonale në punë.

Gjatë vitit 2021, kompania "Lufra" zhvilloi më shumë se 26 programe trajnuese të dedikuara, me ekspertë të huaj dhe vendas, të cilat kishin impakt të menjëhershëm në rritjen e produktivitetit e kënaqësisë në punë.

# Zhvillimet teknologjike

## Në fabrikë

Implementimi i makinerive moderne për prodhimin e kosit, gjalpit dhe prodhimin të shisheve ambalazhuese. Në 2021 kemi edhe zgjerimin e një pjese të fabrikës e cila do shërbejë për prodhimin e produkteve të reja.

## Në logjistikë

Krijimi i një hapsire të madhe të dedikuar për parkimin, shtimi i linjave të distribucionit dhe rritja e punësimit në këtë departament.

Po ashtu ne furgonet frigoriferike është instaluar një teknologji e vecante për matjen e temperaturës dhe sigurimin e kushteve optimale të produkteve.



## Standart dhe cilësi

Gjatë këtij viti kemi arritur me sukses të ndryshojmë të gjitha etiketat sipas ligjit të ri të etiketimit të ushqimit të përshtatur me ligjin Europian të etiketimit, e gjithë kjo e realizuar me suportin e departamentit të ri të cilësisë të strukturuar këtë vit.

Departamenti i cilësisë është një garanci më shumë në fabrikën tonë për të kontrolluar dhe siguruar cilësinë e produkteve të gatshme që ne prodhojmë.



01

**91,9%**

E konsumatorëve kur zgjedhin produktet Lufra kanë në mendje Cilësinë dhe Shijen!

02

**50,2%**

E konsumatorëve konsumojnë qumësht pothuajse çdo ditë

03

**82%**

E të anketuarve në kërkimet tona të tregut e cilësojnë qumështin Tetratop si: Të sigurt, ekologjik, të freskët

**+93%**

E të anketuarve në moshat e reja i besojnë kompanive të kontrolluara dhe certifikuara për sigurinë ushqimore të produkteve të bulmetit, krahasuar me produktet e bulmetit të cilat nuk i përjasin një marke apo standarti të caktuar!

04

**Rritje e ndërgjegjësimit**

Vumë re një rritje të ndërgjegjësimit për produktet e shëndetshme të bulmetit dhe vlerave ushqyese që ata përmbajnë dhe distancim nga produktet jo natyrale.

05

# Preferencat Konsumatore në 2021

## Vizioni ynë

Të bëjmë produktet 'Made in Albania' të dëshiruara dhe të besuara në të gjithë botën!

## Vlerat

1

Konsumatori në vend të parë  
Çdo vendimarrje realizohet duke patur në mendje konsumatorin dhe fjalën e tij

2

Bashkëpunimi dhe Uniteti - Jemi më të fortë sëbashku

3

Integriteti  
Çdo hallkë e biznesit tonë mbron parimet etike, besimin dhe transparencën

4

Mbajtja e premtimeve - Ne kurrë nuk shkelim fjalën e dhënë

5

Drejtësia  
Ne bëjmë gjithmonë atë që është e drejtë edhe përse mund të jetë e vështirë për ta realizuar

6

Inovacioni dhe ndryshimi  
Ne jemi iniciatorët e inovacionit dhe shohim përtej horizontit

7

Transparenca  
Ne jemi kurdoherë transparentë më konsumatorët, fermerët dhe partnerët tanë duke ofruar produktet më cilësore në treg

8

Zhvillimi i ekipit  
Ne punojmë si ekip dhe zhvillimi i punonjësve përbën një ndër shtyllat e modelit tonë të biznesit

## Misioni

Ti ofrojmë konsumatorëve produktet më të shëndetshme dhe cilësore të bulmetit duke mbështetur fermerët vendas dhe duke punuar me etikë, transparencë dhe besueshmëri.

# Çfarë sjell e ardhmja?

Jemi shumë optimistë për 2022! Zgjerimi gjeografik në Kosovë dhe shtimi i gamës së produkteve të eksportuara në SHBA është vetëm një nga objektivat e 2022. Kemi planifikuar vendosjen e disa produkteve të reja në treg të cilat besojmë se do mirëpriten nga konsumatorët tanë me entuziazëm!

Sigurisht më shumë bashkëpunime me partnerë vendas e ndërkombëtarë, politika të strukturuar organizative dhe investime të reja që mbështesin programet tona të përgjegjësisë sociale. Më shumë suport për fermerët nëpërmjet një projekti ende 'sekret' por shumë frytdhënës që do zbulohet në 2022!



# Fjala e Presidentit

Vizioni ynë është të bëjmë produktet 'Made in Albania' të dëshiruara dhe të besuara në të gjithë botën!

Ne besojmë fort në vizionin dhe vlerat tona.

Çdo hallkë e biznesit tonë mbron parimet etike, besimin dhe transparencën. Pikërisht mbi këto parime, ngrihen edhe programet tona për përgjegjësinë sociale. Mbjajtja e premtimeve, është një element që na diferencon në treg, ne kurrë nuk shkelim fjalën e dhënë!

Z. Arben Ndreka





# Kompania Dukat gjatë 2021

"Të dashur miq,

Të rralla janë kompanitë që në një kohë të shkurtër të arrijnë të dallojnë mes kompanive të tjera më të vjetra, aq më tepër kjo në një treg me dinamikë të lartë si ai i ujit..

Për kompaninë Dukat, ndonëse ende e re në treg, 2021 shënoi dyfishim të shitjeve dhe punonjësve. Dëshiroj të shpreh mirënjohjen time për të gjithë bashkëpunëtorët, konsumatorët, punonjësit dhe partnerët tanë për suportin e dhënë. Gjatë këtij viti ne implementuam sistemin e ri financiar i cili lehtësoi proceset e rregjistrimit të mallrave dhe automatizoi shumë veprime financiare që përkeqeshin në kohë të shpenzuar nga departamenti i financës.

Në shkurt të vitit 2021 ne nisëm eksportet Malin e Zi, ku njohëm një realitet ndryshe nga tregu shqiptar dhe presim të nisim eksportet në Kosovë. Foto të pafundme përtej kufinjve të klientëve të kënaqur që provonin ujin Dukat, një mrekulli e natyrës shqiptare.

Stafi ynë i shitjes me profesionalizëm arriti të zgjerojë shtrirjen gjeografike të tregtimit të produktit. Po ashtu nëpërmjet kërkimeve të shumta të tregut, përkthym zërin e konsumatorëve në inovacione dhe zhvillime të paketimit të produktit duke përmirësuar paketimin e shishes 0.5L të ujit Dukat.

Z. Franc Ndreka, CEO

## Përmirësime të produktit dhe rritje e performancës në treg

Vec ofrimit të një uji me vlerë të lartë për shëndetin, kompania në vetvete ka një fokus të veçantë në mbështetjen e aktiviteteve që promovojnë praktikat më të mira për një shëndet sa më të mirë. Kjo e arritur duke suportuar evente si Triathlon LeBeat në Shkodër i cili konsistonte në gara noti ,vrapimi e çiklizmi.

Jo vetëm kaq, pasi Uji "Dukat" ka mbështetur një mori aktiviteteve argëtuese të njohura në Shqipëri. Këtu përmenden eventet si Turtle Fest, Okla Fest apo South Outdoor Festival, duke u kthyer kështu në brand-in e preferuar të të rinjve që kanë kaluar netët e gjata të verës në këto aktivitete.

## Çfarë presim nga e ardhmja?

Jemi shumë optimistë për vitin që vjen dhe synimi ynë është të dyfishojmë shitjet e ujit Dukat. Po ashtu në planet tona është shtimi i kapaciteteve të magazinimit, më shumë trajnime për shitjet, negociatat dhe zhvillim të stafit për një qasje inovatore ndaj tregut dhe konsumatorit.







dukat<sup>®</sup>